

VENDIM
Nr. 373, datë 26.12.2023

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY 24” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/14 prot., datë 20.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energy 24’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Energy 24” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2354/1 prot., datë 23.11.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 80, datë 31.05.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 363, datë 7.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e kësaj licence.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.12.2023 dhe 9.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 593/12 prot., datë 7.12.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 593/13 prot., datë 13.12.2023, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 16, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikën 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Energy 24” sh.p.k., për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 1.6.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti